



Besimi ndaj  
**SAHABËVE**



Titulli:  
**“Besimi ndaj sahabëve”**

Ligjëroi:  
**Hoxhë Lulzim Perçuku**

Kontrolloi:  
**Hoxhë Lulzim Perçuku**

Transkriptoi:  
**Albiona Olluri**

Kopertina dhe faqosja:  
**Denisa Zeqiri**

*Korrik-Shtator 2025*

# HYRJE

Kur përmenden sahabët – shokët e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, atëherë pa dyshim se, kuvendet, ligjëratat dhe librat do të zbukurohen. Si të mos jetë kështu kur përmendja e tyre është përmendje e të dashurve të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem?!

Çdo mirësi që na ka arritur neve e me të cilën stolisemi, prej çështjeve të fesë, na ka arritur përmes sahabëve. Andaj, ata kanë shumë vlerë dhe kanë të drejta ndaj nesh. Dhe pasuesit e sunetit, të drejtat e tyre, janë munduar t'i përmbushin në mënyrën më të mirë.

» Fjala “**sahab**”

Sahab është shumësi i fjalës sahib që do të thotë shoqëruar apo shok. Ndërsa, kjo fjalë në kuptimin fetar do të thotë: Ai i cili e ka parë/takuar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem duke e besuar dhe i cili ka vdekur në Islam. Madje, qoftë vetëm nëse e ka parë atë, atëherë atij i takojnë vlerat apo një pjesë e tyre, të përmendura për sahabët në Kuran dhe në hadithe.

Në vijim do të flasim për biografitë dhe vlerat e katër udhëheqësve të drejtë.

## BIOGRAFIA E EBU BEKRIT, RADIJALLAHU ANHU

Më të mirët prej sahabëve janë dhjetë të përgëzuarit me Xhenet, ndërsa më të mirët prej tyre janë katër udhëheqësit e drejtë, e prej këtyre më të mirët janë Ebu Bekri dhe Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë.

Me pajtueshmërinë e të gjithë dijetarëve, më i miri i këtij umeti është udhëheqësi dhe zëvendësi i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, Abdullah Ebu Bekër es Siddik ibn Uthman. Ai ka qenë më i miri prej sahabëve.

Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, Ebu Bekri ka qenë ai i cili e ka pranuar i pari Islamin (prej burrave, të lirë e jo skllëvër). Transmetohet se ai në një rast ka thënë për veten e tij: *“A nuk jam unë i pari që e kam pranuar Islamin?!”* Tirmidhiu.

Ebu Bekri e ka marrë detyrën si udhëheqës me pajtueshmërinë e të gjithë sahabëve, pas vdekjes së Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Udhëheqja e tij ka zgjatur përafërsisht dy vjet e tre muaj.

Ai ka vdekur në moshën 63 vjeçare. Namazin e xhenazes ia ka falë Umeri radijAllahu anhu dhe e kanë varrosur në dhomën ku ka qenë i varrosur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem.

## ARGUMENTET QË FLASIN PËR VLERËN E TIJ

Ebu Bekri ka qenë njeri me pozitë të lartë dhe bëma të mëdha sa i përket Islamit. Ai ka qenë i veçuar me virtyte dhe vlera. Andaj, sahabët ia kanë besuar atij pozitën e udhëheqësit dhe i janë zotuar për besnikëri.

◆ Transmetohet se një grua ka ardhur te Pejgamberi salallahu alejhi ue dhe e ka pyetur: *“Nëse vij në vitin e ardhshëm dhe nuk të gjej ty, atëherë kujt t’i drejtohem?”* Dhe ai salAllahu alejhi ue selem i është përgjigjur: **“Nëse nuk me gjen mua, drejtoju Ebu Bekrit.”** *Buhariu.*

◆ Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Allahu më dërgoi te ju dhe më përgënjeshtrohat, ndërsa Ebu Bekri më besoi e tha: “Të vërteten e thua.” Ai më ndihmoi me veten e tij dhe me pasurinë e tij. A ma lini të qetë shokun tim të veçantë (sahibi)? A ma lini të qetë shokun tim të veçantë (sahibi)?”**

◆ Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Allahu ia ka lënë nën mundësi një njeriu (robi të Tij) të zgjedhë mes kësaj jete (të jetojë) me të gjitha të mirat e saj dhe të mirave dhe**

**të mirave dhe shpërblimit të Allahut në botën tjetër, dhe ai zgjodhi shpërblimin i cili është tek Allahu.”** Kur i dëgjoi Ebu Bekri këto fjalë, filloi të qajë, dhe të pranishmit u çuditën. Mirëpo, ai e kuptoi dhe e diti se ky rob i Allahut është vetë i Dërguari salallahu alejhi ue selem. Pastaj e qetësoi Ebu Bekrin dhe tha: **“Njeriu i cili më së shumti më ka bërë mirë me shoqërinë dhe pasurinë e tij, është Ebu Bekri. Sikur ta merrja dikë për halil (të dashur) përveç Zotit tim, do ta merrja Ebu Bekrin. Mirëpo, në mes nesh (mes tij dhe Ebu Bekrit) mbetet vëllazëria dhe dashuria islame.”** *Transmeton Buhariu.* Halil është shkalla më e lartë e dashurisë. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem ka qenë halil i Allahut.

◆ Transmetohet se Umeri radijAllahu anhu ka thënë: *“Ebu Bekri është zotëria ynë, më i mirë në mesin tonë, më i ngrituri dhe më i dashuri te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem.”*

◆ Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është pyetur: *“Kush është njeriu më i dashur tek ti?”* Ai është përgjigjur: **“Aisha.”** Është pyetur përsëri: *“Prej burrave?”* Dhe është përgjigjur: **“Babai i saj (Ebu Bekri).”**

◆ Ebu Bekri e ka shoqëruar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem kur kanë mërguar për në Medine

(kanë bërë hixhret) dhe gjatë ndjekjes së idhujtarëve janë strehuar në shpellë. Kur idhujtarët janë afruar shumë te shpella, Ebu Bekri i ka thënë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem: *“Nëse ndonjëri prej tyre do të shikojë këmbët e veta, do të na vërejë.”* Mirëpo, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka thënë: **“Çfarë mendon, o Ebu Bekër, për dy persona me të cilët Allahu është i treti?!”** Kjo fjalë tregon për pozitën e lartë që ka pasur Ebu Bekri. Dhe Allahu ka zbritur ajetin: **“Nëse ju nuk e ndihmoni atë, Allahu tashmë e ka ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesit vetë të dytin, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit): “Mos u pikëllo, se Allahu është vërtet me ne!”** *Teube 40.* Allahu e quan Ebu Bekrin **“shokut të vet”**. Ai ka arritur hisen më të plotë të të qenët shok i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem.

◆Ka ajete kuranore për të cilat shumë komentues të Kuranit thonë se kanë zbritur për Ebu Bekrin, prej tyre: **“Ata që kanë ardhur me sinqeritet dhe kanë besuar të vërtetën, ata janë të devotshmit.”** *Zumer 33.* **“E do të mbahet larg tij (zjarrit) më i devotshmi (që ruhet nga gjynahet), që e jep pasurinë e tij, duke pastruar veten dhe duke mos pritur shpërblim prej dikujt tjetër për këtë, por vetëm për të kërkuar Fytyrën (kënaqësinë) e Zotit të tij, më të Lartit.”** *Lejl 17-20.*

## BIOGRAFIA E UMERIT RADIJALLAHU ANHU

Umeri radijAllahu anhu është më i miri i besimtarëve pas Ebu Bekër es Siddikut.

Atë e ka quajtur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem “*El Faruk – Dalluesi*”. Allahu përmes Umerit e ka dalluar të vërtetën prej të pavërtetës, ngase kur Umeri e ka pranuar Islamin atëherë sahabët e kanë adhuruar Allahun haptazi te Qabja (deri në atë kohë e kanë adhuruar fshehtas).

Ai është Umer ibn Khatabi ibn Nufeil ibn Abduluzze. Kunja e tij: Ebu Hafs. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem kështu e ka quajtur në betejën e Bedrit, për shkak të trimërisë së tij. Hafs do të thotë: Këlyshi i luanit.

Ai e ka pranuar Islamin në vitin e gjashtë pasi ka zbritur Shpallja, në moshën 27 vjeçare. Muslimanët janë gëzuar shumë me hyrjen e tij në Islam dhe kjo fe është bërë më e fuqishme në Meke. Madje, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka lutur Allahun ta ndihmojë Islamin me një rën prej këtyre dy personave: Umerin ose Ebu Xhehlin, dhe Allahu ka caktuar që Umeri të jetë ai.

Transmetohet se Abdullah ibën Mesudi ka thënë: “*Prej që Umeri ka hyrë në Islam, ne kemi vazhduar*

*të jemi të ngritur e krenarë.” Buhariu.*

*Dhe: “Islami i Umerit ka qenë çlirim. Hixhreti i tij ka qenë fitore. Udhëheqja e tij ka qenë mëshirë. Para se të hynte në Islam, ne nuk kemi guxuar të shkojmë te Qabja. E kur ka hyrë ai në Islam, është rrahur dhe kapur me idhujtarët derisa na kanë lënë të qetë dhe kështu e kemi adhuruar Allahun lirshëm te Qabja.”*

Umeri radijAllahu anhu ka udhëhequr në mënyrën më të mirë. Gjatë udhëheqjes së tij muslimanët kanë çliruar shumë vende. Khilafeti i tij ka zgjatur për 10 vjet e gjashtë muaj.

Në vitin 23 hixhri, në ditën e mërkurë, skllavi i Mugire ibën Shubes e ka goditur Umerin tri herë me thikë (me dy koka), kur Umeri ka dalë të zgjojë njerëzit për namazin e sabahut.

Ai (para vdekjes) ka thënë: *“Pasha Allahun! Dëshiroj të dal prej kësaj dunjaje zero-zero (as me të mira e as me të këqija) dhe që shoqërimi që ia kam bërë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem të më pranohet tek Allahu.”*

Ai është varrosur në dhomën e Aishes (ku ka qenë i varrosur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe Ebu Bekri), me porosi prej tij, dhe për këtë ka marrë leje prej Aishes radijallahu anha. Namazin e xhenazes ia ka falë Suhejbi.

## ARGUMENTET QË FLASIN PËR VLERËN E TIJ

◆ Transmetohet prej Sad ibn Vekasit se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirt im, o biri i Khatabit, sa herë që shejtani të ka takuar në një rrugë veçse e ka ndërruar e ka shkuar në një tjetër rrugë.”** *Buhariu dhe Muslimi*. D.m.th. nuk ka pasur guxim të takohet me të, për shkak të besimit të lartë të Umerit dhe mbështetjes së tij së madhe tek Allahu.

◆ Transmetohet prej Ebu Hurejres radijAllahu anhu se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Vërtet, në popujt e mëhershëm ka pasur njerëz të inspiruar.<sup>1</sup> Nëse ndokush është i këtillë nga umeti im, atëherë ai është Umeri.”** *Buhariu*.

◆ Transmetohet se Ebu Bekri ka thënë: *“Nuk ka dikush i cili është më i dashur tek unë në fytyrën e tokës sesa Umeri.”* Ai e ka lënë me porosi (në ditën e vdekjes së tij) që Umeri të jetë zëvendësi i tij (udhëheqës pas tij). Dhe kur e kanë pyetur se çfarë do t’i thuash Zotit tënd, ai është përgjigjur: *“Do t’i them Zotit tim se ua kam lënë si udhëheqës më të*

---

<sup>1</sup>Njerëz të sinqertë e të vërtetë në mendimet e tyre, janë të inspiruar prej engjëjve, apo njerëz që flasin të vërtetën e të saktën pa qëllim (pa dashje). Dhe Umeri shpeshherë ka dhënë mendime, e pastaj ka zbritur ajeti i cili ka vërtetuar se mendimi i tij ka qenë i sakti.

*mirin prej tyre.” Umeri ka qenë më i miri pas Ebu Bekrit.*

◆ Transmetohet se Aliu ka thënë: *“Kur të përmenden besimtarët e devotshëm, i pari prej tyre (të cilin e përmendim) është Umeri.”*

◆ Transmetohet se Abdullah ibën Mesudi ka thënë: *“Nëse dija e Umerit do të vendosej në një rën anë të peshores dhe dija e të gjithë njerëzve në anën tjetër, atëherë ana ku është vendosur dija e tij do të peshonte më rëndë.”*

◆ Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për Ebu Bekrin dhe Umerin: **“Ata janë zotërinjtë e të rinjve<sup>2</sup> të Xhenetit, prej të parëve dhe të fundmëve, përveç Pejgamberëve dhe të Dërguarve.”** *Sahih.*

◆ Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Sikur të kishte Pejgamber pas meje, ai do të ishte Umer ibn Khatabi.”** *Ahmedi, Tirmidhiu etj.* Dhe: **“Allahu e ka vendosur të vërtetën në gjuhën dhe në zemrën e Umerit.”**

---

<sup>2</sup> Fjala e ardhur në këtë hadith flet për moshën mes 30-40 vjeçare.

## BIOGRAFIA E UTHMANIT RADIJALLAHU ANHU

Më i miri i njerëzve dhe i këtij umeti, pas Ebu Bekrit dhe Umerit radijAllahu anhuma, është Uthmani radijAllahu anhu, njëri prej katër udhëheqësve të drejtë.

Ai është Uthman ibn Affan bin Ebi el As (emri i tij ka qenë El Harith). Nofka e tij ka qenë Dhun - Nurejn – Poseduesi i dy dritave – dy vajzave të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem (së pari ka qenë i martuar me Rukajen dhe pas vdekjes së saj është martuar me Umu Kulthumin). Dijetarët përmendin se askush nuk njihet në histori të ketë pasur për bashkëshorte dy vajza të një Pejgamberi, përveç Uthmanit.

Ka lindur në vitin e gjashtë, pas “Vitet të elefantit”. Ka qenë prej të parëve që ka hyrë në Islam. Ebu Bekri ka qenë shkaku që ai të hynte në Islam. Ai është njëri prej të dhjetëve për të cilët Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka dëshmuar se do të hyjnë në Xhenet dhe është njëri prej të gjashtëve të cilët kanë vdekur duke qenë i kënaqur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem me ta. Kohëzgjatja e udhëheqjes së tij ka qenë 12 vite.

Uthmani ka qenë njëri prej sahabëve i cili e ka tubuar Kuranin në musaf. Ka qenë i bukur në pamje. Përmendet se ka agjëruar shumë, ka falë shumë namaz nate dhe ka lexuar shumë Kuran.

Ai është vrarë si dëshmor në shtëpinë e tij në vitin 35 Hixhri, sipas disa transmetimeve në moshën 82 vjeçare e në disa transmetime 90 vjeçare. Rrethimi ndaj tij ka zgjatur 49 ditë sipas disa transmetimeve, ndërsa në disa të tjera thuhet se ka zgjatur 2 muaj. Në ditën e vrasjes ka qenë agjërueshëm dhe është vrarë duke lexuar Kuran, ku një pikë e gjakut të tij ka rënë në ajetin kuranor: **“Allahu të mjafton ty kundër atyre. Ai i dëgjon dhe i di të gjitha.”** *Bekare 136*. Namazin e xhenazes ia ka falë Zubejr ibn Awwami dhe është varrosur në varrezën Beki.

## ARGUMENTET QË FLASIN PËR VLERËN E TIJ

◆ Transmetohet se një ditë ka hyrë Uthmani te Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i cili ka pasur gjuhët të zbuluar dhe i ka mbuluar dhe ka thënë: **“A të mos turpërohem prej një njeriu prej të cilit turpërohen edhe engjëjt?!”** *Buhariu dhe Muslimi.* Uthmani ka qenë shumë i turpshëm.

◆ Transmetohet se kur Uthmani është rrethuar në shtëpinë e tij (ku dhe është vrarë dhe ka rënë dëshmor), ka dalë para njerëzve dhe ka thënë: *“A nuk e dini se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush e përgatit “Ushtinë e vështirësisë” (e cila ka luftuar me romakët), atij i takon Xheneti?” Dhe unë isha ai që e kam përgatitur atë. A nuk e dini se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush e hap/blen pusin er rume me pasurinë e tij dhe ua jep muslimanëve do ta ketë Xhenetin si shpërblim?” Dhe unë isha ai që e kam blerë atë.”* *Buhariu.*

Me këto fjalë ka dashur t’iu thotë atyre që e kanë rrethuar se jeni duke bërë një krim shumë të madh.

◆ Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Uthmani është më i turpshmi në umetin tim dhe më fisniku.”** Dhe: **“Njeriu më i turpshëm i këtij umeti pas Pejgamberit është Uthmani.”**

◆ Abdullah ibn Umeri ka thënë: “*Sa ka qenë gjallë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ne (sahabët) thoshim: “Më i mirë i këtij umeti (pas Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem) është Ebu Bekri, pas tij Umeri, pas tij Uthmani, pastaj heshtnim.” Këto fjalë i shkonin atij salAllahu alejhi ue selem dhe nuk i refuzonte.*”

◆ AbduRrahman ibn Aufi ka thënë: “*Kam pyetur banorët e Medines dhe kam parë se ata nuk e krahasonin askënd me Uthmanin.*”<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Kur njeriu beson se Aliu ka qenë më meritör për udhëheqje (khalifat) sesa Uthmani, ka rënë në bidat, madje disa prej bidatxhinjëve thonë se Aliu ka qenë më meritör për këtë sesa Ebu Bekri.

## BIOGRAFIA E ALIUT RADIJALLAHU ANHU

I katërti i khalifëve të drejtë është Aliu, më i miri i këtij umeti pas tyre, i cili nuk i është ndarë kurrë mirësisë dhe i cili gjithmonë ka qenë i suksesshëm në mirësi. Ai ka qenë babai i dy Hasenave (Hasenit dhe Husejnit – nipat e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem) dhe djali i Ebu Talibit – xhaxhai i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem.

Ai ua ka tejkaluar bashkëmoshatarëve të tij, ka qenë njeri bujar dhe me moral të mirë. Ai ka qenë çelësi dhe hapësi i çdo vështirësie.

Prej katër khalifëve, Aliu ka qenë më i afërmi me Pejgmaberin salallahu alejhi ue selem sa i përket prejardhjes. Kjo është një vlerë e veçantë që i takon atij. Khilafeti i tij ka zgjatur katër vjet e nëntë muaj.

Aliu është bërë udhëheqës pasi Uthmani ka rënë dëshmor. Kur ka ndodhur vrasja e tij, njerëzit kanë shpejtuar të shkojnë tek Aliu dhe i kanë thënë: *“Zgjate dorën të ta japim zotimin për besnikëri!”* Mirëpo ai u ka thënë: *“Nuk u takon juve kjo gjë, por u takon sahabëve që kanë marrë pjesë në luftën e Bedrit. Nëse ata janë të kënaqur për të qenë unë udhëheqës, atëherë do të jem.”* Pastaj ata të gjithë kanë ardhur

tek Aliu dhe i kanë thënë: “*Nuk shohim dikë tjetër më meritore për udhëheqje sesa ty. Zgjate dorën të ta japim zotimin për besnikëri!*”

Aliu është sulmuar duke u goditur në kokë (nga dy persona prej havarixhëve), kur ka dalë të falë namazin e sabahut, para derës së shtëpisë së tij, në ditën e xhuma.

Kur ka vdekur ka qenë në moshën 63 vjeçare. Namazin e xhenazes ia ka falë Haseni. Është varrosur në Kufe, në pallatin presidencial.

## ARGUMENTET QË TREGOJNË PËR VLERËN E TIJ

◆ Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Aliu është prej meje dhe unë jam prej tij. Ai është miku dhe i dashuri i çdo besimtari që vjen pas meje.”** *Sahih.*

◆ Aliu radijAllahu anhu ka thënë: “*Pasha Atë i Cili e bën farën të mugullojë dhe i Cili ka krijuar të gjitha krijesat, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ma ka dhënë besën se mua do të më dojë vetëm besimtari dhe do të më urrejë hipokriti.*” *Muslimi.*

◆ Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nesër do t’ia japë flamurin një personi të cilit Allahu**

**do t'ia mundësojë të çlirojë Hajberin. Ai e do Allahun dhe të Dërguarin e tij dhe Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë.”** Pastaj njerëzit e kanë kaluar natën duke biseduar e diskutuar se kush mund të jetë ky person. Në mëngjes, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka pyetur: **“Ku është Aliu?”** I kanë treguar se është sëmure në sy. Atëherë ka kërkuar t'ia sillnin, dhe pasi ia kanë sjellë, ka fryrë në sytë e tij dhe është lutur për të dhe Allahu ia ka shëruar sytë sikur mos të kishte asgjë. Pastaj ia ka dhënë flamurin.

◆ Abdullah ibn Abbasi ka thënë për të: *“Sado që të ketë folur për fe, nuk e ka tepruar - ka pasur dije të madhe për fe. Ka qenë prej të parëve që ka hyrë në Islam dhe ka qenë dhëndri i Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Ai ka pasur të kuptuar rreth sunetit. Ka qenë trim dhe i është përgjigjur menjëherë ftesës për luftë dhe ka qenë bujar.”*

◆ Umeri radijAllahu anhu ka thënë: *“Aliu është më i ditur në mesin tonë lidhur me gjykimin.”* Abdullah ibën Mesudi ka thënë gjithashtu: *“Më i dituri rreth gjykimit, prej banorëve të Medines, është Aliu.”*

Imam Ahmedi ka thënë: *“Aliu radijAllahu anhu nuk është stolisur me khilafet (udhëheqësi), por khilafeti është stolisur me të.”*

## BIOGRAFITË E GJASHTË TË PËRGËZUARVE ME XHENET

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për katër udhëheqësit e drejtë: **“(Kur të ndodhin fitnet) Kapuni pas sunetit tim dhe sunetit të udhëheqësve të drejtë e të udhëzuar të cilët do të vijnë pas meje! Kapuni fort pas tij dhe shtrëngojeni (siç e mbani një gjë) me dhëmballë!”** Dhe: **“Udhëheqja (hilafeti) e cili është sipas rrugës së Pejgamberisë do të zgjasë 30 vite, pastaj Allahu do t’i japë sundim/mbretëri atij që dëshiron (do të vijnë mbretër).”<sup>4</sup>** *Ahmedi dhe të tjerë.* Dhe hadithe të tjera.

Pas katër udhëheqësve të drejtë, vjen grupi i gjashtë të përgëzuarve me Xhenet. Nuk ka dyshim te pasuesit e sunetit për përgëzimin e tyre me Xhenet, për mirësinë që Allahu ua ka dhënë dhe se ata do të jenë prej banorëve të Xhenetit. Ata janë: Seidi, Sadi, Ibn Aafi, Talha, Amiri dhe Zubejri. Këta, së bashku me katër khalifët e drejtë, janë dhjetë të përgëzuarit me Xhenet.

---

<sup>4</sup> Udhëheqja e Ebu Bekrit ka zgjatur 2 vite e 3 muaj, e Umerit ka zgjatur 10 vite e 6 muaj, e Uthmanit ka zgjatur 12 vite dhe e Aliut ka zgjatur 4 vite e 9 muaj. Ndërsa, 6 muajt e mbetur për të mbushur 30 vitet halifat, janë muajt e udhëheqjes së Hasenit radijAllahu anhu i cili pastaj ia ka dorëzuar udhëheqjen Muavijes i cili dhe llogaritet mbreti i parë në Islam

◆ **Seid ibën Zejdi** – Ai ka qenë prej të parëve të cilët kanë hyrë në Islam. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha betejat me Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem, përveç betejës së Bedrit (ngaqë ka qenë i ngarkuar të përcjellë lëvizjet e karvanit të kurejshëve i cili ka qenë duke u kthyer prej Shamit, dhe pastaj të lajmërojë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem). Seidi ka qenë i gjatë, ezmer dhe leshatak. Ai ka vdekur në luginën Akik, dhe pastaj është varrosur në Medine, në vitin 51 hixhri, në moshën mbi 70 vjeçare. Seidi ka transmetuar 48 hadithe. Ai ka thënë: *“Unë dëshmoj për nëntë persona që janë në Xhenet (dhe përmend ata) dhe nuk do të mëkatoja sikur të dëshmoja për të dhjetin.”* E kanë pyetur se kush janë ata dhe i ka përmendur, pastaj e kanë pyetur se kush është i dhjeti, atëherë ka heshtur dhe ka thënë: *“Unë.”*

◆ **Sad ibën ebi Uekasi** – Ai ka qenë prej atyre që kanë pranuar Islamin në fillimet e tij, kur ka qenë në moshën 17 vjeçare. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha betejat me Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. Tregohet se ka qenë i shkurtër dhe i shëndosh, ka pasur kokë të madhe dhe gishtërinj të mëdhenj. Ka qenë ezmer dhe me qime shumë. Gjatë khilafetit të Umerit dhe Uthmanit, ka qenë i caktuar si prijës i Kufes. Ai ka vdekur në vitin 55 (apo 57) hixhri, në shtëpinë e tij në Akik, në moshën mbi 70 vjeçare dhe

është varrosur në Medine në varrezat Beki. Sadi ka transmetuar 270 hadithe. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Gjuaji me shigjeta (idhujtarët)! I bëfsha kurban për ty nënën e babanë tim!”** Aliu ka thënë: *“Nuk e kam dëgjuar për dikë t’i ketë bërë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem kurban të dy prindërit e tij (me fjalë) përveçse për Sad ibën Uekasin.”*


◆ **AbduRrahman ibn Aufi** – Ka qenë prej atyre që e kanë pranuar Islamit në fillimet e tij. Ai ka emigruar në Etiopi dy herë. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha betejat me Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. Ai ka qenë i gjatë, i bardhë (i përzier me ngjyrë kafe), ka pasur supe të gjera dhe hundë të lakuar. Tregohet se dy dhëmbët e parë i ka pasur të rënë dhe ka qenë i çalë (ngaqë është plagosur në betejën e Uhudit). Ka vdekur në vitin 32 hixhri dhe është varrosur në varrezën Beki, në moshën mbi 70 vjeçare. Ka transmetuar 65 hadithe. Abdurrahman ibën Aufi ka qenë ai i cili ka shpenzuar për gratë e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem pas vdekjes së tij. Përmendet se e ka dhënë lëmshë një kopsht i cili është shitur 40.000 dënar (apo 400.000 dënar) dhe këto para i ka lënë lëmshë për t’u shpenzuar për gratë e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem.

◆ **Talha ibën Ubejdilah** – Ka qenë prej të parëve që ka hyrë në Islam. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha betejat me Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem përveç betejës së Bedrit (ngaqë edhe ai sikur Seidi, ka qenë i ngarkuar të përcjellë lëvizjet e karvanit të kurejshëve i cili ka qenë duke u kthyer prej Shamit). Ai është dalluar në betejën e Uhudit për mbrojtjen që ia ka bërë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem me trupin e tij. Shigjetat e hedhura në drejtim të të Dërguarit, i ka kapur me dorën e tij. Për këtë arsye, është goditur me shigjeta në dorën e tij dhe pastaj i janë paralizuar gishtërinjtë. Në këtë betejë, thuhet se ka marrë 24 plagë, ndërsa në një transmetim thuhet se ka marrë 74 plagë (me shtiza, apo me shigjeta, apo me shpata), duke qëndruar si mur para Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem për të mos u goditur. Dhe ai salAllahu alejhi ue selem e ka quajtur “Talha i mirësisë” (po në këtë betejë). Ai ka qenë ezmer e leshatak, ka pasur flokë të gjatë e të mëdha, dhe ka qenë i bukur në fytyrë. Ai është vrarë në betejën e Xhemelit, në vitin 36 hixhri, në moshën 64 (apo 62) vjeçare. Është varrosur në Basra. Talha ka transmetuar 38 hadithe. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për të në betejën e Uhudit: **“Është bërë obligim Xheneti për Talhan!”** *Tirmidhiu.*

◆ **Ebu Ubejde ibën Xherrah** – Ka qenë prej të parëve që ka pranuar Islamin. Ka mërguar në Habeshe dy herë. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha betejat me Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. Edhe Ebu Ubejde ka qëndruar në mbrojtje të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem (si mur) në betejën e Uhudit. Me dhëmbët e tij ka nxjerrë dy rrathët e helmetës që i janë futur në faqen e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe nga kjo i kanë rënë dy dhëmbët e përparmë. Ai ka qenë i gjatë dhe me mjekër të rrallë (jo të dendur). Ai ka vdekur nga murtaja në Jordani, në vitin 18 hixhri, në moshën 58 vjeçare, dhe është varrosur në një varrezë aty afër. Ebu Ubejde ka transmetuar 15 hadithe. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për të: *“Çdo umet ka besnikun e vet, kurse besniku ynë o umet është Ebu Ubejd ibën Xherrah.”* Dhe: *“Ky është besniku i këtij umeti.”*

◆ **Zubejr ibën Awami** – Ka qenë prej të parëve që ka hyrë në Islam, kur ka qenë në moshën 16 vjeçare. Xhaxhai i tij e ka torturuar me tym për ta braktisur Islamin, mirëpo nuk e ka braktisur. Ka mërguar në Habeshe dy herë. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha betejat me Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. Përmendet se ai ka qenë i pari i cili ka nxjerrë shpatën për të luftuar në rrugën e Allahut. Ai ka

qenë i bardhë e i gjatë dhe thatanik (në një transmetim thuhet se ka qenë mestar dhe ezmer). Është vrarë duke u kthyer prej betejës së Xhemelit, në Basra, në vitin 36 hixhri, në moshën 64 vjeçare. Zubejri ka transmetuar 38 hadithe. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për të: **“Çdo Pejgamber ka pasur përkrahësit e tij, kurse përkrahësi im është Zubejr ibën Awami.”** *Timirdhiu.*



Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem (duke i përmendur me emra veç e veç) ka thënë:

**“Ebu Bekri është në Xhenet. Umeri është në Xhenet. Uthmani është në Xhenet. Aliu është në Xhenet. Talha është në Xhenet. Zubejri është në Xhenet. Abdurrahman ibën Aufi është në Xhenet. Sad ibën ebi Vekasi është në Xhenet. Seid ibën Zejdi është në Xhenet. Ebu Ubejde ibën Xherrah është në Xhenet.”**  
*Shënon Tirmidhiu.*

## DISA SAHABË TË TJERË TË SHQUAR

Nga besimi i pasuesve të sunetit është që të mos dëshmojmë për askënd se do të jetë prej banorëve të Xhenetit përveç atyre për të cilët ka dëshmuar Allahu dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Ndërsa, për ata që janë besimtarë të mirë, shpresojmë se do të jenë në Xhenet (ngase ne nuk dimë se çfarë fsheh njeriu në zemrën e tij).

Sa i përket sahabëve, në mënyrë të përgjithshme, të gjithë ata do të jenë në Xhenet.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka përgëzuar me Xhenet dhjetë prej sahabëve, siç kemi përmendur, mirëpo ka përgëzuar edhe të tjerë. Këta të dhjetë quhen *“Të përgëzuarit me Xhenet”* ngaqë janë përmendur me emra brenda një hadithi. Pastaj ka edhe të tjerë të cilët i ka përgëzuar me Xhenet, si:

◆ **Thabit ibën Kajsi** – Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për të: “Ai është prej banorëve të Xhenetit.” Buhariu dhe Muslimi.

◆ **Haseni dhe Husejni**<sup>5</sup>, dy djemtë e Aliut dhe Fatimes – Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për ta: **“Haseni dhe Husejni janë dy**

---

<sup>5</sup> Ata janë të pastër prej rrugës së rafidhave (shijave). Ata janë imamë të ehli sunetit.

**zotërinjtë e të rinjve të banorëve të Xhenetit.” Dhe: “O Allah! Unë i dua ata, dua ju edhe Ti!” *Tirmidhiu.***

◆ **Ukashe ibën Mihsan** – Ai i ka thënë Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem që ta lusë Allahun ta bëjë prej 70.000 personave, të cilët do të hyjnë në Xhenet pa dhënë llogari e pa u dënuar (siç është përmendur në hadith), dhe ai salAllahu alejhi ue selem i ka thënë: **“Ti do të jesh prej tyre!”** *Buhariu dhe Muslimi.*

◆ **Abdullah ibën Selam** – Transmetohet se Sadi ka thënë: *“Nuk e kam dëgjuar Pejgamberin salallahu alejhi ue selem t’i thotë diku prej të gjallëve, i cili ecën në fytyrën e tokës, se do të jetë prej banorëve të Xhenetit, përveç Abdullah ibën Selamit.”* *Buhariu dhe Muslimi.*

◆ **Khadixhja, Aisha dhe të gjitha gratë e tjera të Pejgamberit salallahu alejhi ue selem.**

◆ **Fatimja**, vajza e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, i cili ka thënë për të: **“Fatimja është një pjesë e imja. Kush e zemëron atë, më ka zemëruar mua.”** *Buhariu dhe Muslimi.* Dhe: **“Ajo do të jetë zonja e banorëve të grave të Xhenetit.”** *Buhariu dhe Muslimi.* E njëjta gjë ka ardhur për Hadixhen, Aishen, Merjemen dhe Asien. Ato janë gratë më të mira në mesin e grave të botës.

◆ **Bilali** – Transmetohet se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem i ka thënë atij: **“Kam dëgjuar zhurmën e nallaneve të tua në Xhenet.”**

## AISHA RADIJALLAHU ANHA

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka fejuar Aishen kur ka qenë 6 vjeçe. Tregohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka thënë asaj: **“Të kam parë ëndërr tre netë radhazi. Tek unë të solli Engjëlli (Xhibrili) në një mbështjellëse prej mëndafshi, dhe më tha: “Kjo do të jetë bashkëshortja jote.” E zbuloi fytyrën tënde dhe e pash se je ti. Thash: “Nëse kjo është prej Allahut, atëherë le të bëhet ajo që është caktuar!”** Dhe ëndrrat e Pejgamberëve janë Shpallje. Pastaj e ka martuar Aishen posa ka shkuar në Medine, në vitin e parë hixhri, kur ajo ka qenë 9 vjeçe.<sup>6</sup> Kur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka vdekur, ajo ka qenë në moshën 18 vjeçare. Ajo ka vdekur në Medine, në vitin 58 hixhri, në ditën e martë (17 Ramazan) dhe është varrosur në varrezën

---

<sup>6</sup> Në atë kohë, por edhe sot, në vendet e nxehta, sidomos në ato arabe, vajzat hynë herët në moshën madhore; në moshën 9 vjeçare veçse konsiderohen të rritura. Më parë, njerëzit kanë qenë më të pjekur dhe kur dikush ka hyrë në moshën madhore, ka qenë në gjendje të marrë të gjitha përgjegjësitë mbi vete. Edhe vajzat kanë qenë në gjendje të marrin në përgjegjësi të gjitha obligimet familjare. Nuk ka qenë problem për Aishen martesë në atë moshë. Ajo ka hyrë në moshën madhore në moshën 9 vjeçare dhe i ka kryer të gjitha obligimet si grua ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem. Për ta vërtetuar më shumë këtë, është fakti se para se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ta kërkojë atë për martesë, e ka kërkuar një person tjetër. Kjo tregon se në atë kohë kjo gjë ka qenë normale dhe nuk ka qenë problem, mirëpo njerëzit me mentalitetin e sotshëm i gjykojnë rrethanat e asaj kohe. Duhet të zbrasin në tokën e asaj kohe dhe të gjykojnë me syrin siç i kanë parë gjërat njerëzit e po asaj kohe. Për këtë arsye në të kaluarën kurrë nuk ka ndodhur që dikush të akuzojë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem për këtë gjë, as mushrikët (idhujtarët) e Mekës nuk kanë thënë: "Ja çfarë ka bërë, e ka marrë për grua një nëntë vjeçe!" Kjo sepse ajo në moshën 9 vjeçare ka hyrë në moshën madhore dhe është konsideruar grua.

Beki, me porosi që të varrosej gjatë natës.<sup>7</sup> Namazin e xhenazes ia ka falë Ebu Hurejra.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për të: **“Vlera e Aishes në krahasim me gratë e tjera është sikur vlera e theridit (një ushqim) në krahasim me ushqimet e tjera.”** Aisha radijAllahu anha ka qenë gruaja më e mirë në krahasim me gratë e tjera të tij salAllahu alejhi ue selem sa i përket dijes dhe kuptueshmërisë së fesë. Në këtë aspekt gratë e tjera nuk krahasohen me të. Edhe sahabët më të mëdhenj, kur kanë pasur diçka të paqartë apo dilemë, janë drejtuar tek Aisha dhe i kanë kërkuar përgjigje (fetua).

Mirëpo, dijetarët kanë mospajtime se a është më e mirë dhe më e vlefshme Aisha apo Hadixhja. Disa e kanë vlerësuar më shumë njërën, disa tjetrën, disa nuk janë prononcuar. Mendimi më i saktë: Secila prej këtyre të dyjave kanë pasur veçori dalluese nga njëra-tjetra. Kështu, Hadixhja ka pasur rol dhe ndikim të madh në fillimin e Islamit (ajo e ka përkrahur Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem, e ka ngushëlluar, ia ka lehtësuar brengat, e ka motivuar, ka dhënë prej vetes çdo gjë, qoftë kohë, mund apo pasuri).

---

<sup>7</sup> Ajo ka qenë shumë e ndershme dhe e dëlirë. Nuk ka dashur të shihej duke u varrosur gjatë ditës.

Ndërsa, roli i Aishes ka qenë në fund të Islamit (ajo ka pasur dije, ka bartur hadithe të shumta etj.). Aisha ka përcjellë prej dijes atë që asnjëra prej grave të tjera nuk e ka përcjellë. Ajo është prej atyre që kanë transmetuar më së shumti hadithe (2210 hadithe) dhe e cila më së shumti e ka përhapur sunetin e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem. Dobia e saj për umetin ka qenë më e madhe sesa e grave të tjera të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe grave në përgjithësi.

Aisha ka pasur të kuptuar të fesë, ka qenë e dijshme, oratore, ka pasur virtyte të larta. Ajo përveç transmetimit të shumë haditheve, ka pasur njohuri edhe për ngjarjet që u kanë ndodhur arabëve, apo për poezitë dhe për vlerat e tyre.

Asnjë grua nuk e ka martuar duke qenë e virgjër përveç Aishes. Ajo madje është lavdëruar me këtë gjë. Transmetohet se Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem i ka zbritur Shpallja sa ka qenë i mbuluar me mbulesë (të shtratit) bashkë me Aishen.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka dashur më shumë Aishen sesa gratë e tjera – e ka dalluar me dashuri. Transmetohet se Pejgamberin salallahu alejhi ue selem e kanë pyetur se kush është njeriu më i dashur tek ti dhe është përgjigjur: **“Aisha.”**

Allahu ka zbritur Shpallje prej mbi shtatë qiej mbi Arshin e Tij, për të pastruar Aishen prej akuzës që i është bërë në nderin e saj, ajete këto që lexohen në mihrabe dhe në namaze deri në Ditën e Kiametit, me të cilat Ai dëshmon se Aisha është prej grave të dëlira, të pastra, **“Gratë e ndershme janë për burra të ndershëm dhe burrat e ndershëm janë për gra të ndershme. Ata janë të pastër nga shpifjet që thuhën (kundër tyre) dhe do të falen e do të kenë një shpërblim bujar (në Xhenet).”** *Nur 26.* Duke qenë se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është i mirë dhe i ndershëm, atëherë edhe gratë e tij janë të tilla. Kjo tregon për dëlirësin dhe pastërtinë e Aishes. Ajo ka qenë e tillë në të gjitha aspektet.

## MUAVIJE RADIJALLAHU ANHU

Muavije ka qenë prijësi i besimtarëve. Ai ka hyrë në Islam pas çlirimit të Mekës. Ka qenë prej sahabëve më të vlefshëm. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ia ka besuar atij shkrimin e Shpalljes. **Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem është lutur për të: “O Allah, bëje Muavijen udhëzues për të tjerët dhe të udhëzuar (në veten e tij)!”** *Tirmidhiu.* Dhe: **“Është bërë obligim Xheneti për ushtrinë e parë prej umetit tim e cila do të luftojë në det.”** *Buhariu.* Komandanti i kësaj ushtrie ka qenë Muavije.

Ebu Bekri, Umeri dhe Uthmani radijAllahu anhumu e kanë caktuar Muavijen për udhëheqës për njëzetë vite radhazi. Udhëheqja e tij ka vazhduar edhe njëzetë vite pas fitnes (që ka ndodhur mes tij dhe Aliut). Të gjithë dëshmojnë se Muavije ka qenë i drejtë dhe i mirë me ata që kanë qenë nën udhëheqjen e tij. Ai është bërë udhëheqës i Shamit pas vdekjes së vëllait të tij Jezidit.

Ehli suneti thonë se Muavije gjatë hilafetit të Aliut nuk ka qenë halife, por ka qenë mbret – udhëheqës. Muavije në raport me fitnen që ka pasur me Aliun,<sup>8</sup> ka qenë muxhtehid (e ka dhënë mendimin e tij dhe shpërblehet për të, porse ka gabuar në të, ndërsa e vërteta ka qenë në anën e Aliut). Pas vdekjes së Aliut dhe dorëzimit të hilafetit që ka bërë Haseni (me zgjedhjen e tij të lirë) të Muavija, atëherë hilafeti i Muavijes ka qenë i vërtetë. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem e ka lavdëruar Hasenin duke thënë: **“Biri im është zotëri. Allahu përmes tij do të pajtojë dy grupe të mëdha të muslimanëve.”**

Muavije ka qenë shumë bujar në rrugën e Allahut. Kjo ka qenë prej tipareve të tij. Gjithashtu njeri i dijshtëm, i butë dhe i drejtë.

---

<sup>8</sup> Aliu dhe Muavija kanë qenë sahabë – shokë të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe të dytë hyjnë tek ajeti: “...Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim, edhe ata janë të kënaqur me Atë.” *Teube 100*. Kush fyen apo mallkon njërin prej tyre, atij i takon mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i njerëzve.

Ai ka transmetuar 136 hadithe.

Ka vdekur në Damask, në vitin 60 hixhri, në moshën 87 vjeçare (apo 82, apo 86). Përmendet se ka poseduar disa gjëra të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, si: izarin e poshtëm, këmishën, disa qime dhe thonj. Ka porositur të qefinoset me këmishën dhe izarin e Pejhamberit salAllahu alejhi ue selem, ndërsa në vendet e sexhdes t'i vendosen thonjtë dhe qimet e tij.

## VLERA E MUHAXHIRËVE DHE ENSARËVE

Muhaxhirët janë para ensarëve – janë më të vlefshëm tek Allahu. Allahu të parët i përmend muhaxhirët në Kuran, pastaj ensarët, si në ajetin: **“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim, edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!”** *Teube 100.*

Muhaxhirët kanë sakrifikuar veten dhe pasurinë e tyre dhe kanë lënë shtëpitë/vendbanimet e tyre për hir të Allahut për të lartësuar Fjalën e Allahut (që të

triumfojë feja e Tij). Për këtë ndihmë që ia kanë bërë fesë, ata do të shpëtojnë prej errësirës së Zjarrit. Allahu thotë: **“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t’u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet).”** *Ali Imran 185*. Pa dyshim se muhaxhirët dhe ensarët e kanë hisen më të madhe në këtë mirësi. Ata janë njerëzit më meritore të shpëtojnë prej zjarrit të Xhehenemit dhe të futen në Xhenet.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Muhaxhirët dhe ensarët do të jenë miq të njëri-tjetrit, në këtë botë dhe tjetrën.”** *Ibën Hibani*. Dhe ka thënë për sahabët të cilët ia kanë dhënë besën nën pemë: **“Askush prej atyre të cilët janë zotuar për besnikëri nën pemë, nuk do të hyjë në Xhehenem.”** *Tirmidhiu*.

Ensarët janë ata të cilët e kanë strehuar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe shokët e tij, janë kujdesur ndaj tyre, i kanë përkrahur me pasurinë dhe vetët e tyre, madje u kanë dhënë përparësi mbi vetët e tyre në shumë gjëra.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë për ta: **“Ensarët i do vetëm besimtari dhe i urren vetëm hipokriti. Kush i do ensarët, Allahu e do atë. Kush i urren ensarët, Allahu e urren atë.”** *Buhariu dhe Muslimi*.

Dhe: **“Shenjë e besimit është dashuria ndaj ensarëve. Shenjë e hipokrizisë është urrejtja ndaj tyre.”** *Buhariu dhe Muslimi*. Dhe: **“Nuk ka mundësi që dikush i cili beson Allahun dhe Ditën e Fundit të urrejë ensarët.”** *Tirmidhiu*.

Është lutur për ta: *“O Allah, fali ensarët, fëmijët e tyre dhe fëmijët e fëmijëve të tyre!”* *Buhariu dhe Muslimi*.

## VLERA E TABIINËVE

Tabiinët vijnë pas sahabëve në vlerë dhe pozitë. Tabii është ai i cili ka parë sahabët (duke qenë besimtar) dhe i ka pasuar ata në rrugën e drejtë.

Është obligim të besojmë se njerëzit më të mirë pas Pejgamberëve janë sahabët, ndërsa më të mirët pas tyre janë tabiinët (gjenerata pas sahabëve).

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Njerëzit më të mirë janë brezi im (sahabët), pastaj brezi që vijnë pas tyre (tabiinët), pastaj brezi që vijnë pas tyre (tabi tabiinët).”**<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë në një hadith se pas këtyre tri gjeneratave “Do të përhapet gënjeshtra.” Dhe gënjeshtra më e madhe që është përhapur ka qenë bidati në fe. Brezi i tabitabiinëve përfundon në vitin 220 hixhri, dhe pas kësaj kanë filluar të shfaqen me të madhe bidatet në fe. Kështu, mutezilitë kanë liruar gjuhët e tyre, janë shfaqur edhe xehemitë me ideologjitë e tyre, kanë ngritur kokat filozofët, batinitë kanë filluar të ligjërojnë e të ftojnë te bidatet e tyre, kanë filluar të sprovohen imamët e fesë – dijetarët që të thonë se Kurani është i krijuar e nuk është Fjalë e Allahut (siç ka ndodhur me imam Ahmedin i cili ka qëndruar në mënyrën më të mirë përball kësaj fitneje).

Imam ibën Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) duke folur për tabiinët, ka thënë: *“Sahabët fisnik, ua kanë dhënë tabiinëve atë që kanë marrë prej burimit të pastër të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem.”*

Për këtë, është obligim të njohim vlerën e tabiinëve dhe virtytet e tyre.

## TË DREJTAT E SAHABËVE NDAJ MUSLIMANËVE

### ► *Dashuria ndaj sahabëve – t’i duam ata*

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem ka thënë: **“Shenjë e besimit është dashuria ndaj ensarëve dhe shenjë e hipokrizisë është urrejtja ndaj tyre.”** *Buhariu dhe Muslimi.*

Ensarët janë banorët e Medinës të cilët e kanë ndihmuar Pejgamberin salallahu alejhi ue selem. Dijetarët thonë se kjo gjë është më parësore për muhaxhirët - banorët e Mekës, të cilët kanë bërë bashkë mes ndihmës ndaj tij salAllahu alejhi ue selem dhe hixhretit (migrimin në Medine). Muhaxhirët janë më të vlefshëm sesa ensarët (në Kuran përmenden të parët). Andaj, muslimani e ka për obligim të dojë shokët e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, për hir të Allahut, ngase Ai na ka urdhëruar t’i duam ata.

Imam Maliku ka treguar se selefët ua mësonin fëmijëve të tyre dashurinë ndaj Ebu Bekrit dhe Umerit radijAllahu anhuma, ashtu siç ua mësonin suret e Kuranit.<sup>10</sup>

► ***Besimi se sahabët janë njerëz me plot vlera, të besueshëm dhe më të mirët pas Pejgamberëve***

Për këtë dëshmon Fjala e Allahut: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin...”** *Ali Imran 110.*

Ibën Tejmije ka thënë për sahabët: *“Ai që shikon në biografitë e sahabëve, me dituri dhe largpamësi, dhe shikon vlerat e virtytet me të cilat Allahu i ka begatuar ata, do të dalë në përfundim me bindje se ata kanë qenë njerëzit më të mirë pas Pejgamberëve. Nuk ka pasur si ta, në popujt e kaluar, e nuk do të ketësi ta deri në Ditën e Kiametit. Si të mos jetë kështu kur vetë Allahu i ka lavdëruar në Kuran, duke thënë: “Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!”* *Teube 100.*

---

<sup>10</sup> Duke ua përsëritur, duke mos u lodhur a mërëzitur, duke qenë të vazhdueshëm, duke i motivuar dhe nxitur – në këtë mënyrë ua kanë mësuar dashurinë ndaj sahabëve. Ata ua kanë përmendur atyre sahabët, virtytet, ngjarjet dhe historitë e tyre, në mënyrë që dashuria ndaj tyre të rrënjoset në zemrat e fëmijëve.

Ndërsa, nga hadithet që flasin për vlerën e sahabëve përmendim: **“Njerëzit më të mirë janë brezi im – sahabët. Pastaj brezi që vjen pas tyre. Pastaj brezi që vjen pas tyre.”** *Buhariu dhe Muslimi*. **“Mos i fyeri e ofendoni shokët e mi! Nëse ndonjëri prej jush do të shpenzonte ar prej pasurisë së tij, sa mali i Uhudit, nuk do të arrinte vlerën e shpenzimit të një sahabiu i cili ka dhënë ushqim (lëmoshë) sa dy grushte apo një grusht.”** *Buhariu dhe Muslimi*.

Allahu i ka nderuar ata të shoqërojnë Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem (për shkak se kanë pasur zemra të mira e të devotshme) dhe të dëgjojnë Shpalljen që i ka zbritur atij. Sahabët bartën këtë fe me plot besnikëri deri tek ne. Ata konsiderohen të drejtë dhe besnikë.

### ► *Besimi se ndërmjet sahabëve ka dallim (në vlera)*

Të gjithë sahabët janë të mirë, mirëpo disa prej tyre janë më të vlefshëm. Më të mirët ndër sahabët janë dhjetë të përgëzuarit me Xhenet. Më të mirët ndër këta janë katër udhëheqësit, pastaj më të mirët ndër këta janë Ebu Bekri dhe Umeri (këshilltarët e veçantë të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem), e më i mirë mes tyre është Ebu Bekri. Nuk ka njeri më të mirë pas Pejgamberëve sesa Ebu Bekri, e pas tij vjen Umeri, pastaj Uthmani dhe pastaj Aliu.

Pas dhjetë të përgëzuarve me Xhenet, më të mirët janë pjesëmarrësit në betejën e Bedrit (300 e ca).

Pas këtyre, më të mirët janë pjesëmarrësit në betejën e Uhudit (afër 700).

Pas këtyre, më të mirët janë pjesëmarrësit në zotimin për besnikëri (nën pemë) ndaj Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem (afër 1400).

Ndërsa, lidhur me sahabijet, atëherë më të mirat janë: Aisha, Khadixhja dhe Fatimja.

Është obligim për ne të bëjmë dallime (krahasime) mes sahabëve, sa i përket vlerës dhe virtyteve të tyre. Pozita e tyre në zemrat tona duhet të jetë në varësi të krahasimit të tyre (disa duhet t'i duam më shumë).

### **► *Përmendja e sahabëve me fjalë të mira, lavdërimi dhe përhapja e veprave të tyre të mira***

Kjo e drejtë e sahabëve ndaj nesh, është pjesë e dashurisë ndaj tyre. Kur e do dikë me dashuri të sinqertë e të vërtetë, do ta përmendësh me fjalë të mira e lëvdata. Njëjtë është dhe me sahabët, të cilët nëse ne i duam ashtu siç na ka obliguar Allahu dhe i Dërguari i Tij, atëherë patjetër se do t'i përmendim vetëm me fjalë të mira dhe lavdërimi të bukura dhe do të ndalim veten të mos përmendim ndonjë gjë nënvlerësuese për ta, të mos shpifim për ta, të mos i akuzojmë në besnikëri e drejtësi, të mos i ofendojmë

etj.<sup>11</sup> Akuzimi ndaj sahabëve është akuzë ndaj Allahut. Fyerja apo akuza ndaj tyre ka pasoja shumë të rënda. Vetë Allahu i ka lavdëruar dhe ka treguar për vlerën e tyre në Kuran dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka lavdëruar në hadithet e tij.

Allahu dhe i Dërguari i Tij i duan ata, prandaj edhe ne duhet t'i duam. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Njerëzit më të mirë janë brezi im (sahabët)...”**

---

<sup>11</sup> Ndërsa, ata që kanë zemra dhe mendje të përmbysura të cilët akuzojnë dhe shpifin kundër sahabëve, kanë vepruar në të kundërtën e asaj me të cilën janë urdhëruar dhe obliguar.

Cili është gjykimi për atë që fyen sahabët?

-Nëse dikush fyen sahabët apo i mallkon, apo i bën jobesimtarë, apo i akuzon në besnikëri dhe drejtësi, të gjithë ata apo shumicën e tyre, kjo është mohim (kufër), ngase me këtë gjë ka bërë akuzë ndaj Allahut, Kuranit dhe sunetit, sepse ata që na kanë përcjellë Kuranin dhe sunetin janë sahabët.

-Nëse dikush fyen apo akuzon në fe apo besnikëri atë sahabi për të cilin kanë ardhur argumente fetare prej shumë rrugëve (mutewatire) që tregojnë për vlerën e tij, siç është rasti me Ebu Bekrin dhe Umerin, atëherë sipas mendimit më të saktë ai ka mohuar.

-Nëse dikush fyen në fe dhe besnikëri atë sahabi për të cilin nuk kanë ardhur argumentet mutewatire që tregojnë për vlerën e tij, atëherë njëri mendim i dijetarëve thotë se ai ka mohuar, ndërsa mendimi tjetër thotë se ai nuk ka mohuar, përveç nëse e fyen si shok të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem atëherë në këtë rast ka mohuar.

-Nëse dikush fyen dikë prej sahabëve se nuk ka kuptuar shumë, nuk ka pasur zgjuarsia apo dije, apo ka qenë kopracc, lakmitar, apo i paguximshëm e të tilla, ai është bidatxhi.

-Nëse dikush fyen apo akuzon Aishen në nderin e saj – në atë që Allahu e ka shfaqësuar në Kuran, ai ka mohuar sepse me këtë ka përgënjeshtuar Allahun i Cili e ka pastruar atë prej akuzës së imoralitetit.

-Nëse dikush fyen dhe akuzon nënat e besimtarëve – gratë e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem në nderin e tyre, ai ka mohuar sipas shumicës së dijetarëve.

► ***Lutja që Allahu të jetë i kënaqur me sahabët dhe kërkim falja për ta***

Duhet të lutemi për sahabët duke thënë: “Allahu qoftë i kënaqur me ta!” dhe të kërkojmë falje për ta. Kjo është prej besimit të pasuesve të sunetit. Dhe për këtë na mëson Allahu siç thotë: **“Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh...”** *Hashr 10*. Sheukani (Allahu e mëshiroftë!) duke komentuar ajetet: **“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë.”** *Ahzab 56*, përmend se shumica e dijetarëve të umetit kanë pajtueshmëri se për sahabët themi *“Allahu qoftë i kënaqur me ta!”*, ndërsa për ata që vijnë pas tyre themi: *“Allahu i mëshiroftë!”*

Kjo lutje e bërë për sahabët (për të gjithë ata), është caktuar si lutje e veçantë vetëm për ta. Andaj, sa herë që përmenden sahabët, ne duhet të lutemi që Allahu të jetë i kënaqur me ta. Kjo është një e drejtë e tyre ndaj nesh.

E gjithë kjo për shkak të mundit, luftës që kanë bërë krahas Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, virtyteve, moraleve dhe sakrificës për të arritur Kënaqësinë e Allahut dhe për të ngritur lart Fjalën e Tij. Për këtë ata kanë sakrifikuar çdo gjë.

Pasuesit e sunetit, në raport me sahabët, bëjnë bashkë mes zemrës së shëndoshë dhe gjuhës së pastër. Kjo është prej parimeve të ehli sunetit. Besimtari nuk guxon të ketë urrejtje apo ndonjë gjë të keqe në zemrën e tij, gjithashtu gjuha e tij duhet të jetë e pastër ndaj tyre.

► ***Urrejtja ndaj atyre të cilët i urrejnë sahabët dhe nuk i përmendin për të mirë***

Duhet t'i urrejmë dhe t'i armiqësojmë të tillët, ngase Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Nyja më e fortë e besimit është të duash dhe të urresh për hir të Allahut.”** Cilët mund të jenë më parësorë që t'i urrejmë, sesa ata që armiqësojnë dhe ofendojnë sahabët?! Nuk ka mundësi të bëhet bashkë dashuria ndaj sahabëve dhe dashuria ndaj armiqve të tyre. Këto dy gjëra janë të kundërta me njëra-tjetrën dhe nuk bëhen bashkë. Kushdo që është i sinqertë në dashurinë ndaj sahabëve dhe beson vlerën e tyre, patjetër duhet të urrejë dhe armiqësojë armiqtë e tyre dhe t'i mbrojë ata (sahabët) ndaj shpifjeve që ua bëjnë.

► ***Dëshmia se sahabët i ka përfshirë Mëshira e Allahut***

Duhet të dëshmojmë se sahabët i ka përfshirë Mëshira e Allahut, në përgjithësi, dhe se ata do të jenë në

Xhenet, dhe gjithashtu këtë ta dëshmojmë për ata për të cilët kanë ardhur argumente të veçanta se do të jenë banorë të Xhenetit.

Allahu thotë: **“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim, edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!”** *Teube 100*. Për këtë arsye, edhe ibën Hazmi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Themi në mënyrë të prerë se të gjithë sahabët do të jenë në Xhenet, ngase Allahu ka thënë: “Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo Allahu u premtonte të gjithëve më të mirën (Xhenetin).”* *Hadid 10*.

### ► *Heshtja ndaj fitneve që kanë ndodhur mes sahabëve*

Allahu ka caktuar që ndërmjet sahabëve të ketë fitne dhe luftëra. Ehli suneti janë të pajtimit se është obligim për çdo musliman të heshtë dhe të mos hulumtojë rreth fitneve që kanë ndodhur ndërmjet sahabëve. Njëri prej dijetarëve ka thënë: *“Për atë që ka ndodhur ndërmjet sahabëve, duhet të heshtim, ndërsa shpërblimin e ixhtihadit (që kanë bërë) e pohojmë për secilin prej tyre.”* Për të gjitha ato fitne e luftëra që kanë ndodhur ndërmjet sahabëve, ehli suneti besojnë

se sahabët qëndrojnë mes një apo dy shpërblimeve. Secili prej tyre ka qenë muxhtehid (ka dhënë mundin dhe përpjekjen e tij për t'ia qëlluar të vërtetës). Kështu, ai që ia ka qëlluar të vërtetës ka dy shpërblime, ndërsa ai që nuk ia ka qëlluar ka një shpërblim.

Arsyet pse duhet të mbajmë këtë qëndrim në lidhje me ato që kanë ndodhur ndërmjet sahabëve:

- Kështu ka porositur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem: **“Kur të përmenden shokët e mi, heshtni.”** *Hasen*. Qëllimi është kur të përmenden luftërat, fitnet dhe vrasjet ndërmjet tyre.
- Nuk përfitojmë dobi nëse futemi në ato gjëra.
- Në ato çështje kanë futur shumë gjëra të pasakta njerëzit e bidatit. Për këtë arsye, shumica e transmetimeve rreth tyre janë të pasakta.
- Kush hyn në ato gjëra, nuk është i sigurt që t'i lindë në zemër diçka prej urrejtjes apo armiqësisë ndaj ndonjërit prej sahabëve (dhe me këtë ia hap vetes derën e shkatërrimit dhe devijimit).<sup>12</sup>
- Është e vështirë ose e pamundur të dihet realisht se çfarë ka ndodhur ndërmjet sahabëve sepse ka qenë kohë e fitneve. Nuk ka ndonjë transmetues që ka

---

<sup>12</sup> Kur dijetarët kanë folur për çështjet ndërmjet sahabëve, këtë e kanë bërë për të sqaruar të saktat e tyre dhe për t'iu kundërpërgjigjur atyre që kanë futur gjëra të pasakta në këtë çështje.

transmetuar në detaje ngjarjet e ndodhura dhe rrethanat (por janë bashkuar transmetimet, qëndrimet, fjalët etj.).

► ***Heshtja ndaj transmetimeve të përcjella për sahabët të cilat të bëjnë të ndjesh të kundërtën e asaj që është e njohur për ta***

Ajo që është e njohur për sahabët është se ata kanë pasur vlerta të larta dhe se do të jenë prej banorëve të Xhenetit. Porse disa njerëz kanë sjellë disa transmetimeve që janë në të kundërtën e kësaj.

Parim tek Ehli suneti është se sahabët janë njerëz me vlera e virtyte të larta dhe janë të besueshëm. Ata janë në nivelin më të lartë të njerëzores sa i përket besimit, mirëpo nuk janë të pagabueshëm<sup>13</sup> (disa prej bidatxhinjëve besojnë se ata janë të pagabueshëm).

► ***Pasimi i sahabëve dhe ndjekja e rrugës së tyre***

Kjo vjen si rezultat i të gjitha të drejtave që kemi përmendur deri tani. Allahu thotë: **“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim...”**  
*Teube 100.*

---

<sup>13</sup> Transmetimet që flasin për ndonjë sahab se ai ka bërë ndonjë mëkat, duhet të palosen e dhe të mos transmetohen.

Allahu na obligon të ndjekim rrugën e sahabëve nëse duam që Ai të jetë i kënaqur me neve ashtu siç ka qenë i kënaqur me ta. Dhe: **“Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra)!”** *Teube 119*. Disa nga selefi kanë thënë: *“D.m.th. bëhuni me Ebu Bekrin dhe Umerin dhe me vëllezërit e tyre (sahabët).”* Po ashtu, Pejgamberi salallahu alejhi ue semel ka thënë: **“Kush jeton prej jush, do të shohë fitne të shumta e trazira në umet. Kur të ndodhë kjo, kapuni pas sunetit tim dhe sunetit të udhëheqësve të drejtë e udhëzues, të cilët do të vijnë pas meje, kapuni pas sunetit të tyre dhe shtrëngojeni fort me dhëmballë!”**

Është obligim ndjekja e rrugës së sahabëve, dhe këtu përfshihet:

- *Kuptueshmëria e Kuranit dhe sunetit, siç i kanë kuptuar ata.*
- *Heshtja për ato gjëra për të cilat kanë heshtur ata, sepse ata na kanë paraprirë në çdo gjë të mirë.*

Pasimi i rrugës së sahabëve është një çështje obligative. Këtë e kërkon edhe mendja e shëndoshë.

Abdullah ibën Mesudi radijAllahu anhu ka thënë: *“Kush dëshiron të marrë dikë për modellshembull për ta ndjekur, le t’i marrë për të tillë ata që kanë vdekur: shokët e Pejgamberit salAllahu alejhi ue semel. Ata kanë qenë njerëz me zemrat më të devotshme në umet,*

*më të dijshtmit dhe ata të cilët më së paku e kanë tepruar në fe. Ata i ka përzgjedhur Allahu të shoqërojnë Pejgamberin sa Allahu alejhi ue selem dhe me ta të ngrehë lartë fenë e Tij. Njihuani vlerën atyre dhe ndiqni rrugën e tyre, ngase ata kanë qenë në rrugën e drejtë.”*

Dhe tek ata që janë bashkuar këto tri cilësi: zemra e devotshme, dija e thellë dhe mosteprimi në fe, atëherë tek ta janë bashkuar të gjitha të mirat, e këta kanë qenë sahabët.

Në suren Fet’h ka ajete në të cilat Allahu i lavdëron sahabët. Ajo është e mbushur me argumente të shumta që tregojnë për vlerën e sahabëve. Ajo ka zbritur në vitin 6-të, pas marrëveshjes së Hudejbijes. Përmendim disa prej ajeteve të kësaj sure:

✦ **“Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t’ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës...”** *Ajeti 4.*

✦ **“Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre! Ai që e prish betimin, e prish në dëm të vetes, por, nëse e mban besën ndaj Allahut, Ai do t’i japë atij shpërblim të madh.”** *Ajeti 10.*

✦ **“Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t’u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç’kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe**

i shpërbleu me një fitore të afërt.” *Ajeti 13.*

✦ “Dhe, kur në zemrat e mohuesve u shfaq zelltaria pagane, Allahu zbriti qetësinë e Tij në zemrën e të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve e i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përkushtimit (ndaj Allahut). Ata kishin më të drejtë e qenë më të denjë për të.” *Ajeti 26.*

Pastaj në fund të sures flitet në përgjithësi për vlerën e sahabëve:

✦ “Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut.<sup>14</sup> Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.” *Ajeti 29.*

Lusim Allahun të na mundësojë dhe të na forcojë në ndjekjen e rrugës së tyre!

---

<sup>14</sup> Ata përshkruhen në këtë ajet se bëjnë shumë vepra të mira dhe namaz, gjithashtu se janë të sinqertë në to (kanë ihlas).